# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-434144**

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Droni rus hyn në Moldavi dhe kërcënon avionin e Zelenskyt, mbyllet menjëherë hapësira ajrore |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/10/droni-rus-hyn-ne-moldavi-dhe-kercenon-avionin-e-zelenskyt-mbyllet-menjehere-hapesira-ajrore/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 06:01:35 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 10 shtator 2026, 05:54:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 10 shtator 2026, 05:53:00 UTC → 10 shtator 2026, 05:55:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9e74fc3dcc8ca370a5243e87ddb69eea8b60251924037b8ff3fc762c72b0433f` |
| TEKSTI | `4e5368340100b98eb5a8e4d8bb8f3b0b9cd6731e91b6dd85d57651e510342bc3` |
| PAMJA | `ca5709056e6a39f49dbed80697d150642004cc7df3bdc37cbcf93abdf7c67339` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1b779a5da0db7c1cfc7e2ff77cdb2cc8cc6099ab533e93eed86a02689d78ac42` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a484fd2fd8d3c694a0f52d2933c72090fea90d464b8c9ac4e0085765a9e0c5b7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1b779a5da0db7c1cfc7e2ff77cdb2cc8cc6099ab533e93eed86a02689d78ac42`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

# Droni rus hyn në Moldavi dhe kërcënon avionin e Zelenskyt, mbyllet menjëherë hapësira ajrore

10/09/2026 07:54




**Një dron rus ka hyrë në hapësirën ajrore të Moldavisë të martën, duke shkaktuar mbylljen e përkohshme të hapësirës ajrore dhe vonuar nisjen e avionit që transportonte presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky drejt Norvegjisë.**

Avioni i Zelenskyt ndodhej në aeroportin ndërkombëtar të Kishinauit dhe u lejua të ngrihej vetëm pasi autoritetet konstatuan se droni kishte rënë. Sipas raportimeve, ai shpërtheu rreth 160 kilometra larg aeroportit.

Ambasadori i Moldavisë në SHBA, Vladislav Kulminski, tha se incidenti ka gjasa të mos ketë qenë aksidental. Ai deklaroi se autoritetet moldave nuk besojnë se një dron me motor reaktiv do të hynte në territorin e vendit vetëm për qëllime vëzhgimi, në një kohë kur avioni i presidentit ukrainas ndodhej në tokë.

I pyetur nëse droni mund të ketë pasur si objektiv Zelenskyn, Kulminski tha se hetimet janë ende në zhvillim dhe se është herët për të nxjerrë një përfundim. Megjithatë, ai theksoi se dihet që presidenti ukrainas përdor hapësirën ajrore moldave gjatë udhëtimeve të tij jashtë vendit.

Incidenti u bë publik nga kryeministri norvegjez Gahr Støre, i cili deklaroi se avioni i Zelenskyt "pothuajse u godit nga një dron" teksa ishte gati të ngrihej nga Moldavia.

Autoritetet moldave njoftuan gjithashtu se një dron i dytë kaloi nëpër hapësirën ajrore të vendit dhe vazhdoi fluturimin drejt Rumanisë. Dronët rusë kanë hyrë në mënyrë të përsëritur në hapësirat ajrore të Moldavisë dhe Rumanisë gjatë luftës në Ukrainë.

Presidentja e Moldavisë, Maia Sandu, i dënoi inkursionet, duke i cilësuar ato si një kërcënim serioz për jetën e njerëzve. Ajo dënoi gjithashtu një sulm rus me dron ndaj një pike kufitare me Ukrainën, ku mbetën të vrarë dy persona.

Zelensky udhëtoi më pas drejt Norvegjisë, ku mori pjesë në ceremoninë mortore të mbretit Harald V, së bashku me liderë të tjerë botërorë.

Pas Norvegjisë, presidenti ukrainas udhëtoi drejt Kanadasë, ku pritet të zhvillojë takime me qeverinë e kryeministrit Mark Carney dhe të mbajë një fjalim para kabinetit kanadez. Zelensky dhe bashkëshortja e tij, Olena Zelenska, do të qëndrojnë në Kanada deri të premten.

**Top Channel**

## Bota »





## Kryesore



Bllokimi i rrugëve nga protestuesit, Rama replikon sërish me "Demokratët Europianë": A do kishit mirësinë ta dënonit dhe këtë akt?
22:59

Video/ Vijon bllokimi i akseve në Tiranë nga protestuesit, disa prej tyre ulën këmbëkryq para autobusit në "Rrugën e Elbasanit"
21:35

Kadastra dhe ATP do të shkrihen në një agjenci/ Një hartë e re unike për pronat, afate 45-ditore për ankesat
19:09

Arti grek në zi, ndahet nga jeta parakohe këngëtari i mirënjohur Giorgos Mazonakis
16:55

Video/ Liverpooli përmbys Atleticon, PSG-ja kampione e nis me festival golash. Mësoni të gjitha rezultatet e mbrëmjes
22:55

## Më të lexuarat

Arti grek në zi, ndahet nga jeta parakohe këngëtari i mirënjohur Giorgos Mazonakis

SPAK njoftim zyrtar, thellohen hetimet ndaj Ballukut/ Sekuestrohet vila në Green Coast, akuza për korrupsion

I lidhën duart, e futën në makinë me qese të zezë dhe e hodhën në lumë, detaje nga ekzekutimi i 35-vjeçarit shqiptar në Itali. Zbulohet identiteti

Panik tek ukrainasit/ Aeroplani i Zelenskyt i shpëton sulmit me dron në Moldavi, ishte nisur drejt funeralit të mbretit norvegjez Harald V

"Nuk ka bërë ndërhyrje", parukieri Olti Shulla tregon për 'Shqipëria Live' sekretet e transformimit të deputetes së PS, Zegjine Çaushi

Përplasja në protestë, Iris Luarasi: Aktivistja që më ofendoi u shoqërua për incidentin me makinën e deputetes Ilva Gjuzi

Video/ "Shikoji shenjat, më janë bërë me urdhër të Luarasit", aktivistja Arvina Lleshi i zë pritë deputetit: Njerëzit që njoh, nuk i...

E trishtë/ Vuante prej vitesh nga problemet në zemër, ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare "Miss Austria"

Analiza/ Filip Çakuli: Republika popullore e protestës



"Ngushticës së Hormuzit do t'i vë emrin tim"/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit

10/09 07:37



Të paktën 5 të vdekur dhe 87 të zhdukur pas zjarrit në një traget në Filipine

10/09 07:27



Përshkallëzohet konflikti Ukrainë-Rusi, Kievi godet me dronë portin më të rëndësishëm rus

09/09 22:43

Kadastra dhe ATP do të shkrihen në një agjenci/ Një hartë e re unike për pronat, afate 45-ditore për ankesat



Tre liderët e fuqive më të mëdha globale në një samit? Kremlini: Takimi Trump-Putin-Xi në Kinë është i mundur të ndodhë

09/09 22:32



Panik tek ukrainasit/ Aeroplani i Zelenskyt i shpëton sulmit me dron në Moldavi, ishte nisur drejt funeralit të mbretit norvegjez Harald V

09/09 21:43



Kaos në fluturimet britanike, afro 2100 anulime/ Ultimatum shefit të kontrollit të trafikut ajror: Raporto brenda një jave!

09/09 21:35

## Kryesore »



"Ngushticës së Hormuzit do t'i vë emrin tim"/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit

10/09 07:37



Të paktën 5 të vdekur dhe 87 të zhdukur pas zjarrit në një traget në Filipine

10/09 07:27



Drogë mes trëndafilave/ Kapen 100 kilogramë kokainë nga Kolumbia në aeroportin e Athinës, arrestohen katër shqiptarë

10/09 07:20




"Barcelona ka ende nevojë për rregullime"/ Flick pas "manitës": Yamal është lojtar i veçantë, e meriton Topin e Artë

10/09 07:11



Vapë në ultësirë, shi në male, ja parashikimi i motit për të enjten

10/09 07:05



Bllokimi i rrugëve nga protestuesit, Rama replikon sërish me "Demokratët Europianë": A do kishit mirësinë ta dënonit dhe këtë akt?

09/09 22:59

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ "Shitet Qeveria"! Bllokime rrugësh, konflikte dhe brohoritma gjatë protestës së 102



Top Channel/ "U sulmua avioni i Zelenskyt", Kryeministri norvegjez: Për pak u rrëzua



Top Channel/ Trump: Putin do marrëveshje, por e urren Zelenskyn









Top News- Lamtumira e Mbretit Harald V! 240 mijë veta në rrugët e Oslos për të përcjell monarkun

Top Channel/ Përshkallëzohet protesta, bllokohen rrugët në Tiranë

Top News- Shënjestrohet me dron avioni i Zelenskyt, lideri i Ukrainës rrezikon jetën në Moldavi



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.